



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 46/6 Prot.

Tiranë, më 08.01 2026

V E N D I M

Nr. 6 dt. 08.01 2026

**“PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT “MASTER I SHKENCAVE” NË
‘SHKENCA SPORTIVE’ MIDIS UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS DHE
UNIVERSITETIT TË URBINOS “CARLO BO”, ITALI”**

Në zbatim të nenit 3, pika 4 gërma a), nenit 38 të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të e Republikës së Shqipërisë”, Vendimit nr.57, datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, nenit 7 pika 4, gërma a), nenit 20 të Statutit të UST, nenit 11, 54 dhe 55 të Rregullores së UST-së, si dhe në shkresën nr. 39/1 prot., datë 07.01.2026 të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Senati në mbledhjen e datës 08.01.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e hapjes së Programit të përbashkët të studimit “Master i Shkencave” në “Shkenca Sportive” midis Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Universitetit të Urbinos “Carlo Bo”.
2. Ky Vendim i përcillet Bordit të Administrimit.
3. Ky Vendim i përcillet për njohje dhe zbatim FSHL-së, si dhe Drejtorisë Së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA

